



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 626/prot.  
5

Tiranë, më 21. 11. 2022

VENDIM

Nr. 926, Datë 21. 11. 2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ROSIER SA NGA SHOQËRIA YILFERT BENELUX B.V.”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21. 11. 2022, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë shoqërisë Rosier SA nga shoqëria Yilfert Benelux B.V.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë shoqërisë Rosier SA nga shoqëria Yilfert Benelux B.V.

VËREN SE :

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Rosier SA nga shoqëria Yilfert Benelux B.V.

Referuar dokumentit “Marrëveshja për shitjen dhe blerjen e aksioneve në Rosier SA”, [...], palët

janë:

**Blerësi:** Yilfert Benelux B.V., është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuara, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, e cila operon si një shoqëri financiare holding, e krijuar si një SPV, me qëllime të veçanta për realizimin e këtij transaksioni, me aksionar të vetëm Yildirim International Fertilizer Investment B.V., pjesë e Grupit Yildirim.

Grupi Yildirim është aktiv në Shqipëri nëpërmjet filialit të tij Albchrome Holding SHPK.

**Albchrome Holding SHPK,** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka në pronësi të plotë dy filialet:

- *Albchrome SHPK*, prodhuesi më i madh i kromit dhe ferrokromit në Shqipëri, i cili operon nëpërmjet dy kontratave të koncesionit; atë të ndërtimit, operimit dhe transferimit të uzinës së ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit të Përrenjasit e Pojskës, si dhe kontrata e koncesionit për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e minierës së kromit Bulqizë, të fabrikës së pasurimit Bulqizë, të impiantit të seleksionimit dhe të uzinës së ferrokromit Burrel.
- *Vllahen Mining SHPK* operon në fushën e xeheror-kromit në Has, Shqipëri.

**Shitësi:** Borealis AG është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit austriak, me objekt aktiviteti ofrimi i zgjidhjeve inovative në fushat e poliolefinave dhe kimikateve bazë.

Grupi Borealis nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri por realizon të ardhura nëpërmjet shitjeve të kufizuara të plehrave kimikë, kryesisht plehra kimike NPK (përmbajnë nitrat, fosfor dhe kalium) dhe një pjesë e vogël nëpërmjet shitjes së uresë.

**Target:** Rosier SA është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit belg, me objekt aktiviteti prodhimi i plehrave dhe kompozimeve të azotit. Target nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri por ka realizuar të ardhura nga shitjet e kufizuara të plehrave kimikë NPK.

## II. Përqendrimi

Më datë [...], shoqëritë Yilfert Benelux B.V., në cilësinë e blerësit, Borealis AG, në cilësinë e shitësit dhe Yildirim International Investmens Holding B.V., në cilësinë e garantuesit kanë nënshkruar “Marrëveshja për shitjen dhe blerjen e aksioneve në Rosier SA”.

Referuar kësaj marrëveshjeje, [.....].

Referuar nenit 2 të kësaj marrëveshjeje shitësi shet dhe blerësi blen aksionet e nënshkruara dhe të emetuara me efekt që nga mbyllja. Mbyllja e këtij transaksioni do të bëhet pasi të përmbushen një sërë kushtesh paraprake të parashikuara në këtë marrëveshje dhe për këtë arsye palët nuk kanë parashikuar një datë fikse për mbylljen e transaksionit.

Në përfundim të transaksionit, blerësi synon të bëhet pronar i 100% të aksioneve tek Rosier SA, duke marrë kontrollin e drejtpërdrejtë mbi Rosier SA, i cili si rrjedhojë do të bëhet anëtar i Grupit Yildirim.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e Konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit të plehrave kimikë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Rosier SA nga shoqëria Yilfert Benelux B.V. Shoqëria Yilfert Benelux B.V., është pjesë e Grupit Yildirim, aktiv në nivel ndërkombëtar në sektorin minerar dhe aktiv në Shqipëri, vetëm në tregun minerar të prodhimit dhe furnizimit të ferrokromit dhe kromit, nëpërmjet filialit të tij Albchrome Holding SHPK.

Targeti, Rosier SA ushtron aktivitet në prodhimin e plehrave dhe kompozimeve të azotit dhe nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri, por ka të ardhura shumë të kufizuar nga shitjet e plehrave kimikë.

Transaksioni i propozuar do të kryhet jashtë Shqipërisë dhe ka si objekt prodhimin dhe furnizimin e plehrave kimike nga shoqëria Rosier SA në Belgjikë dhe Hollandë.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Rosier SA nga shoqëria Yilfert Benelux B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Leida MATJA**  
  
Zv/Kryetar

**Rezana KONOMI**  
  
Anëtar

**Durim KRAJA**  
  
Anëtar

  
**Denar BİBA**  
Kryetar